



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 17. 09. 2008, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l
i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi dhe Ardian Gjini .

Munguan: Enis Kervan, Nexhat Daci dhe Radmilla Vujoviq.

Në mbledhje me ftesë mori pjesë ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Skender Hyseni.
Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Mbledhja u mbajt në prani të mediave.

Mbledhjen e kryesoi: Xhavit Haliti - zv. kryetar i Komisionit, me këtë

R E N D I T E

- 1. Informatë e ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme z. Skender Hyseni**
- 2. Të ndryshme.**

Xhavit Haliti - Fillimisht e përshëndeti praninë e ministrit z. Skënder Hyseni, për gatishmërinë që t'i përgjigjet ftesës së Komisionit, si dhe ta informojë Komisionin lidhur me problemet, duke e pasur parasysh se ky Komision ka treguar gatishmëri të përhershme të jetë në ndihmë të MPJ-së dhe të Qeverisë, veçanërisht në procesin e lobimit për çështjen e Pavarësisë së Kosovës.

Në vazhdim tha se, edhe konform Rregullores së punës së Kuvendit është paraparë që ministrat të ftohen në interpelancë, si dhe në Komision, që të japin informacione herë pas here me qëllim të bashkërendimit të veprimtarisë me Qeverinë dhe me Kuvendin e Kosovës.

Skënder Hyseni - Tha kam kënaqësinë që sot po bashkëbisedojmë për tërë problematikën komplekse të funksionalizimit të MPJ-së, për pikat strategjike të politikës së MPJ-së, për atë që është detyrë dhe sfidë e veçantë e këtyre kohëve për MPJ-në, për institucionet e Kosovës, për gjithë Kosovën, për njohjet e mëtejme në rrethana normale të një shteti të njohur ndërkombëtarisht dhe të integruar në bashkësinë

ndërkombëtare. MPJ-ja nuk është ministri e lobimit, është Ministri e Punëve të Jashtme dhe lobimi është vetëm një detyrë që ka rastisur të jetë detyrë e kësaj ministrie dhe ne shpresojmë shumë të jetë vetëm përkohësisht detyrë e saj.

Ligji për MPJ-në ka hyrë në fuqi më 15 qershor. Ministri i MPJ-së është nominuar me 4 prill, ndërsa vendimi për nominim e tij është bërë i plotfuqishëm dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor. Kjo tha se, është pengesë krejtësisht e natyrshme dhe legale, sidomos në rrafshin e funksionalizimit të MPJ-së. Ligjërisht MPJ-ja nuk ka pasur mundësi të shpallte konkurse për shërbyesit civilë në MPJ pa hyrë në fuqi ligji, sepse do të ishte jologjore të shpallej ndonjë konkurs për kompletimin e shërbimit civil në MPJ-me para se ligji të hynte në fuqi. Po ashtu MPJ-ja nuk ka mundur para se ligji të hynte në fuqi në çfarëdo forme të fillonte me kompletimin e rrjetit diplomatik të Kosovës. Si parakusht i domosdoshëm për funksionalizimin e Ministrisë është kompletimi i stafit. Funksionalizimi i Ministrisë, natyrisht në disa pjesë të saj, ka qenë parakusht i domosdoshëm edhe sa i përket çështjes së lobimit, sepse për udhëtimet e para të ministrit ose të stafit është dashur të huazohen mjete nga Zyra e Kryeministrit. Sot e kësaj dite ministri i MPJ-së nuk ka veturë dhe e përdor një veturë të huazuar nga institucionet e tjera, sepse jemi të vendosur ta respektojmë edhe Ligjin e prokurimit.

Në vazhdim tha se, Komisionin edhe Kuvendin e Kosovës, gjithsesi edhe opinionin publik e preokupojnë më së tepërmi këto ditë njohjet dhe lobimi për njohje. Një prej detyrave parësore që ia ka vënë vetes MPJ, natyrisht në bashkërendim edhe me dikasteret e tjera të Qeverisë të Kosovës, është kërkesa për çdo ministri që një pjesë të aktivitetit të jashtëm ndërkombëtar t'ia kushtojnë lobimit. Edhe sa i përket angazhimit të Ministrisë edhe të segmenteve të tjera të shoqërisë kosovare për lobim, MPJ-ja e ka një kornizë edhe buxhetore dhe ligjore që e obligon të qëndrojë brenda saj dhe nuk mund të dalë jashtë saj as financiarisht, as ligjërisht.

Në këtë drejtim tha se ka qenë një qëndrim i proklamuar shumë qartë, edhe i ministrit edhe i MPJ-së, që çdo institucion i Kosovës, por gjithsesi edhe çdo individ i saj, shoqëri civile, përfaqësues i asociacioneve të ndryshme, në kuadër të mundësive të veta, të llobojë.

MPJ-ja, njësoj sikurse edhe institucionet e tjera të Kosovës, është përpjekur të bëjë punë modeste, kontribut modest në këtë rrafsh dhe e ka bërë atë që është e mundur.

Institucionet e Kosovës shpeshherë janë kritikuar, se nuk po i vizitojnë shtetet arabe, nuk po marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe në samite të ndryshme shumëpalëshe. Kosova ka bërë përpjekje maksimale të bëjë vizita, për të qenë e pranishme në samite të ndryshme, në takime, në konferenca ndërkombëtare shumëpalëshe, mirëpo ato jo gjithë herë kanë pasur sukses.

Nuk ka vend të Gjirit që ne s'kemi bërë kërkesa, që s'kemi dërguar nota zyrtare diplomatike nga Ministria me kërkesë për takime dhe kontakte bilaterale, qoftë në nivel ministri, qoftë në nivel kryeministri, qoftë në nivel presidenti, por pak nga ato janë realizuar.

Në shumë takime që kam pasur me ambasadorë në vendet e treta, më është thënë se ende ka ngurrim për kontakte, sepse nëpër kryeqytete të ndryshme, druajnë se takimet zyrtare në nivel me zyrtarë të lartë të Republikës së Kosovës, mund të interpretohen si njohje implicite, jo eksplicite, prandaj vende të ndryshme preferojnë njëherë të mos zhvillojnë takime para se të mos kenë marrë vendim për njohje ose mosnjohje.

Nëse nuk kemi marrë pjesë në ndonjë samit ndërkombëtar, jo gjithmonë ka qenë vetëm pse nuk na kanë pranuar, por aty këtu ka pasur sugjerime që prania mundë t'i shkaktojë Kosovës më shumë dëm sesa dobi.

Sa i përket Konferencës së të Painkuadruarve në Teheran, Kosova nuk ka pasur as shans minimal të merrte pjesë, por as nuk ka bërë përpjekje minimale të merrte pjesë, sepse kështu është konkluduar në koordinim të ngushtë me partnerë kyç strategjikë ndërkombëtar të Kosovës.

Kosova nuk e ka komoditetin e acarimit me asnjë vend në botë. Përkundrazi është politik konsistente e saj, që me botën të ndërtojë marrëdhënie të shkëlqyera. Vendeve të Gjirit dhe pjesës dërmuese të vendeve të Ligës Arabe, shumë vendeve anëtare të Konferencës Islamike u është bërë kërkesë për zhvillimin e takimeve dhe fatmirësisht u duk një gjë pozitive me pranimin e kërkesës për takime me sekretarin e përgjithshëm të Konferencës Islamike. Takimi me sekretarin e Ligës Arabe ka qenë takim i mirë, informativ, në të cilin janë trajtuar shumë çështje që lidhen me njohjen e Kosovës, me kulturën e Kosovës,

me traditën dhe natyrisht është thanë aty se Kosova atributet fetare nuk ia vë kusht çështjes së procesit të shqyrtimit të njohjes nga ana e vendeve islamike.

Arsyeja pse shumica e këtyre vendeve nuk e njohin Kosovën duhet të kërkohet në fushatën e egër që e bënë Federata Ruse në rrafsh dhe në mënyra të ndryshme.

Në Asamblenë e Përgjithshme të 63-të të OKB-së, së shpejti do të dihet nëse iniciativa serbe, do të futet në rend dite apo jo. Nëse do të futet në rend dite iniciativa serbe, ajo do të prodhojë efekte të përkohshme jo të mira për Kosovën. Kosova do të bëjë çdo gjë që është në mundësinë e saj ta bllokojë këtë, por Kosova nuk mund të bëjë asgjë më shumë, përpos që të gjitha vendeve që na kanë njohur dhe atyre që nuk na kanë njohur, t'ua bëjë me dije pasojat që i prodhon kalimi eventual i iniciativës serbe në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Kalimi eventual i iniciativës serbe për Kosovën nuk prodhon efekte juridike afatgjata për Pavarësinë e Kosovës, por prodhon efekte anësore, kryesisht të natyrës psikologjike, në rrafshin e njohjes, sepse shumë vende që nuk na kanë njohur deri më tani mund t'i bëjë që të ngurrojnë edhe më.

Nëse kalon iniciativa serbe, ajo nuk prodhon efekte juridike, sepse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mund të japë vetëm mendim këshillues për këtë çështje dhe nuk nxjerr vendim obligativ për asnjë instancë.

Nga të gjitha kontaktet e ditëve të fundit, tha se, është kërkesë eksplicite dhe urgjente që vendet që na kanë njohur, por edhe ato që nuk na kanë njohur, të bëjnë që kjo iniciativë të dështojë, sepse do të ndikojë në mbajtjen e marrëdhënieve të ngrira ndërmjet shumë vendeve të rajonit, për aq kohë sa do t'i nevojitet Gjykatës Ndërkombëtare për ta vënë në rend dite këtë çështje.

Ibrahim Gashi - Tha kam konsideratë për informimin që e bëri ministri në mbledhje, por kam vërejtje procedurale që ky dëgjim i ministrit është bërë në vigjilje të interpelancës. Njëkohësisht tha se në ftesën për mbledhje nuk është e shënuar fare data, por vetëm viti 2008. Sa u përket komenteve nuk kam asnjë koment nga fakti se ne kemi neser nje interpelancë me mundësinë e debatit për çështjet për të cilat e kemi ngritur interpelancën.

Xhavit Haliti - Tha se në mbledhjen e kaluar kemi marrë vendim që Komisioni të mblidhet çdo dy javë në orën 14.00. Kjo është mbledhja e radhës dhe nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Jam autorizuar nga kryetari i Komisionit ta thërras mbledhjen edhe për disa çështje të tjera që do t'i diskutojmë, por njëkohësisht mendoj se çdoherë do të duhej që ministrat para seancave të vijnë në Komision, që ne ta kemi një qëndrim të Komisionit.

Ardian Gjini - Tha se pajtohem me diskutimin e deputetit I.Gashi, se mbledhja e sotme ka qenë e panevojshme. Mendoj se komisionet parlamentare nuk mblidhen për të dhënë mendim para mbajtjes së interpelancave dhe nuk është praktikë e Kuvendit të Kosovës, t'i mblidhë komisionet para interpelancës me përfaqësuesit e Qeverisë. Në vazhdim tha se duhet të përgëzohet ministri, sepse ia ka qëlluar 90% të pyetjeve, që ne opozita kemi dashur t'i bëjmë nesër. Ministri nuk na tregoi çka ka bërë, por na tregoi pse nuk ka bërë. Në fund tha se kjo është një formë e mbyrtjes së debatit të nesërm që nuk ka nevojë të bëhet.

Ramadan Avdiu - Konsideron se është praktikë shumë e mirë kjo që edhe në vigjilje të interpelancës, pavarësisht nga cila ministri të vijë ministri në komision përkatës që të japë informacione.

Sa i përket mbajtjes së kësaj mbledhjeje tha se është marrë vendim që çdo dy javë të mbajmë mbledhje si Komision. Edhe pse nuk është në rregull, jo vetëm te ne, por edhe në vende të tjera, në praktikën parlamentare ekziston një rregull i pashkruar që në prag të interpelancës të mblidhet komisioni përkatës, të bisedohet dhe të merret një qëndrim pak a shumë i njëjtë i shumicës së anëtarëve të Komisionit. Ministria e Punëve të Jashtme, për kohën që e ka pasur prej 15 qershorit e deri më tani, është përpjekur maksimalisht dhe kjo përpjekje duhet të vlerësohet.

Lutfi Haziri - Tha se e falënderoj ministrin për paraqitjen e sfidave të tij si ministër dhe të ministrisë, po ashtu shumica prej nesh kemi ndikuar në ndërtimin e kapaciteteve. Në këtë takim tha se, kam pritur se do të na paraqiten politika të qeverisë, në kornizën ku secili duhet ta ketë rolin e vet, duke e përfshirë edhe mundësinë që kjo diplomaci parlamentare e Komisionit tonë të jetë pjesë e asaj kornize se çfarë politike të jashtme ka Kosova dhe a i përmbahen asaj politike Ministria dhe Qeveria .

Në Konferencën e Islamabadit është mbështetur Plani i Ahtisarit, në të cilën me konsensus ka hyrë edhe Indonezia, që tani është kundër. Në këtë drejtim ka ekzistuar një zbrazësirë ndërmjet Konferencës së Islamabadit dhe Konferencës që është mbajtur në Afrikë, por jo në mungesë tuajën, mendoj atëherë kur Kosova është përfaqësuar nga Ministria e Arsimit, këtu duhet të shohim një kthim prapa.

Nëse këto shtete nesër do ta miratojnë iniciativën e Serbisë do të jetë shume problematike ecja përpara. Në vazhdim tha se, pres që të definohet qartë se cila mund të jetë ndihma ose mbikëqyrja, por edhe roli ynë në politikën e jashtme që pas definimit të qartë angazhimi ynë të jetë i koordinuar mirë.

Mbi të gjitha, tha se, është e rëndësishme për ne se çfarë rrjeti diplomatik do të ndërtojmë, çfarë profili Kosova po dërgon në shtetet që na kanë pranuar ndërkombëtarisht.

Në fund tha se mbështet punën e ministrit dhe në cilësi të deputetit kërkon që ministri të vazhdojë të punojë ashtu siç ka filluar në zbatimin e ligjit edhe në vendosjen e mekanizmit përfaqësues të Kosovës.

Ramë Buja – Ndër të tjera tha se kam pritur se ministri do të na e prezentonte punën e vet në të ardhmen, ndërsa për atë se ka pasur pengesa e dimë të gjithë. Sa i përket çështjes së lobimit jemi në gjendje specifike dhe duhet të bëjmë gjëra specifike për shkak se dihet pozicioni ynë.

Lidhur me çështjen e dhënies së mendimit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për çështjen e Kosovës, tha se nuk e di a është bërë aq sa ka qenë e mundur për ta shmangur këtë mundësi që të futet në rend dite dhe të votohet atje kjo rezolutë.

Sa i përket çështjes së ngrirjes së debatit, tha e përshëndes këtë praktikë dhe kisha dashur që kjo të kalojë në një rutinë që ministrat të na përgjigjen saherë që të ftohen në Komision.

Sabri Hamiti - Tha se me konsensus i kemi caktuar edhe ditën, edhe orën kur do të mbahen mbledhjet e Komisionit. Kjo mbledhje është vendosur të mbahet para 14 ditësh. Ndërsa sa i përket pranisë së ministrit, tha se është e nevojshme që ministri S. Hyseni të jetë i gatshëm sa herë të ketë nevojë Komisioni, të kemi komunikim të rregullt për problemet që dalin nga kjo fushë.

Skender Hyseni - Tha se jam i gatshëm, saherë që obligimet e mia parësore më lejojnë, të jem në Komision, sepse komunikimin ndërmjet ministrit dhe këtij Komisioni e shoh si një hallkë të pazëvendësueshme. Sa i përket çështjes së përfaqësuesve diplomatikë të Kosovës, të ngarkuar me punë të përkohshme juridike, nuk duhet të referohen ambasadorë, sepse nuk mund të ketë ambasadorë Kosova pa u intervistuar në këtë Komision dhe të jepet vlerësimi lidhur me kandidatët.

Ky emërim i përkohshëm i të ngarkuarve të përkohshëm është bërë për ta plotësuar sa më parë vakumin në përfaqësim dhe për ta instaluar një mekanizëm që do ta fillonte përgatitjen logjistike të misioneve diplomatike të ambasadave të Kosovës.

Të ndryshme

Xhavit Haliti – I informoi anëtarët e Komisionit për praktikën e re që është vendosur në Kryesinë e Kuvendit, që të gjitha kërkesat për vizita jashtë Kosovës t'i shqyrtojë fillimisht Komisioni për Punë të Jashtme. Kjo ka për qëllim që të vlerësohet rëndësia e vizitave të deputetëve, si dhe ta kemi një konsolidim të politikës parlamentare në marrëdhënie me jashtë dhe evitimin e disa vizitave pa vendim të Kryesisë.

E kemi një ftesë për pjesëmarrje në seminarin që do të mbahet në Bullgari, të organizuar nga PE, në të cilin janë ftuar katër deputetë dhe katër përfaqësues të administratës së Kuvendit. Sipas ftesës plotësohen kriteret e kërkuara për pjesëmarrje të delegacionit tonë në këtë seminar, për të cilin shpenzimet do t'i përballojë Kuvendi i Kosovës me të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve nga PE.

Në konsultim me shefat e GP-së, për pjesëmarrje në seminar propozoj nga PDK deputetin Ramadan Avdiu, nga LDK Agim Veliu, një përfaqësues nga AAK dhe një përfaqësues të komunitetit serb. Lidhur me pjesëmarrjen e stafit tha se i kam propozuar sekretarit të marrin pjesë një përfaqësues i Komisionit për Punë të Jashtme, një përfaqësues i Komisionit për Integritet Evropian, një zyrtar nga protokolli dhe një përkthyes, emrat e të cilëve do të jepen më vonë.

Sabri Hamiti - Tha se njoftimi që e dha z. Xh. Haliti, tani është një detyrë e Komisionit sipas vendimit të Kryesisë, që praktikohet edhe në Parlamentin e Sllovenisë. Komisioni për Punë të Jashtme do t'i shqyrtojë kërkesat për vizita jashtë vendit dhe në kohën e duhur do t'i rekomandojë Kryesisë për qëndrimin e nxjerrë në Komision. Komisioni pas diskutimeve lidhur me ftesën për pjesëmarrje në Seminarin Parlamentar e nxori këtë

P e r f u n d i m

1. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të lejojë pjesëmarrjen e katër deputetëve, tre zyrtarëve dhe të një përkthyesi në Seminarin Parlamentar të organizuar nga Parlamenti Evropian që do të mbahet në Sofje të Bullgarisë më 1 dhe 2 tetor 2008.
2. Pjesëmarrës në këtë seminar propozohen: deputeti Ramadan Avdiu nga GP-PDK, Agim Veliu nga GP-LDK, një deputet nga GP-AAK, si dhe një deputet nga komuniteti serb.
3. Nga zyrtarët për pjesëmarrje në këtë seminar propozohen: një zyrtar nga Komisioni për Punë të Jashtme, një nga Komisioni për Integritet Evropian, një zyrtar nga protokolli dhe një përkthyes.
4. Shpenzimet për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në këtë seminar propozohet t'i bartë Kuvendi me mundësi të rimbursimit nga Parlamenti Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30min.

Zëvendëskryetar i Komisionit
Xhavit Haliti

Përgatitur nga
Njësia për mbështetje të Komisionit